



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 04 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1653/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI101/19

Parashtrues

Ljubiša Trajković

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
AC-I-16-0209-A0001, të 7 shkurtit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ljubiša Trajković me vendbanim në Vranjë, Serbi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-I-16-0209-A0001] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS) të 7 shkurtit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 18 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 21 qershor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 10 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës DHPGJS, dhe kërkoi nga ajo që të sjellë fletëkthesën.
8. Më 15 gusht 2019, Gjykata përsëriti kërkesën për DHPGJS, lidhur me dorëzimin e fletëkthesës.
9. Më 19 gusht 2019, DHPGJS dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktvendimin e kontestuar.
10. Më 10 nëntor 2020, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur, lëndë e kontestit është vërtetimi i të drejtës së pronës trashëgimore.

12. Më 24 nëntor 1998, Komuna e Kamenicës sipas kërkesës për kthim të tokës, kishte nxjerrë Aktvendim [04-453-9/91] me të cilin M.T.-së dhe të tjerëve iu kishte kthyer, respektivisht vërtetuar e drejta e pronës në parcelat e kadastrave të cekura në vendim.
13. Më 28 janar 2003, parashtruesi i kërkesës së bashku me trashëgimtarët e M.T. përmes avokatit iu kishin drejtuar Komunës së Kamenicës, Departamentit për Gjeodezi Kadastrë dhe Pronë, për regjistrimin e pronës në evidencën e kadastrave.
14. Më 12 dhjetor 2005, Kryeshefi Ekzekutiv i Kuvendit Komunal të Kamenicës përmes vendimit [nr.915] e kishte anuluar vendimin [04-453-9/91] të Komisionit për kthim të tokës të 24 nëntorit 1998.
15. Më 13 shtator 2006, përfaqësuesi i M.T., kishte parashtruar ankesë pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AKK), për shkak të heshtjes së administratës nga zyra kadastrale në Kamenicë.
16. Më 6 nëntor 2006, AKK përmes vendimit [03/346/06] refuzoi si të pabazuar ankesën e M.T. AKK vendimin e saj e arsyetoi në atë mënyrë ku konstatoi se (i) Kadastri Komunal kishte shqyrtuar kërkesën me kohë; (ii) e njëjta është dërguar përmes PTT-së në adresën e avokates së M.T. në Vranjë dhe (iii) ishin pezulluar të gjitha procedurat administrative deri në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.
17. Parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në Gjykatën Supreme kundër vendimit [03/346/06] të 6 nëntorit 2006 të AKK-së.
18. Gjykata Supreme, përmes vendimit [A-U.nr.782/06] refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
19. Më 20 qershor 2008, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë pranë AKK-së, për vazhdimin e procedurës së pezulluar administrative në lidhje me ndërrimin e pronësisë së pronës së paluajtshme.
20. Më 10 tetor 2008, përmes Vendimit [03-847-08], AKK kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për vazhdimin e procedurës së ndërprerë për zëvendësimin e pasurive të paluajtshme, me arsyetimin se (i) Komuna e Kamenicës kishte anuluar vendimin [04-453-9/91] të 24 nëntorit 1998; (ii) dhe që në këtë rast konkret bëhet fjalë për pronë shoqërore, kështu që sipas nenit 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 për themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në këtë entitet përfshihen të gjitha të drejtat dhe kompetencat për të gjitha pronat shoqërore dhe ndërmarrjet në pronësi shoqërore dhe ndërmarrjet publike.
21. Më 21 nëntor 2008, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër Aktvendimit [03-847-08] të AKK të 10 tetorit 2008, me propozimin që të anulohet aktvendimi i AKK-së dhe që i padituri të udhëzohet në ndërrim të pronës në bazë të Aktvendimit [04-463-9/91] të Komisionit për kthim të tokës të 24 nëntorit 1998.

22. Më 13 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [A.nr.1315/2011] miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Aktvendimin [03-847-08] të AKK të 10 tetorit 2008 me arsyetimin se: (i) aktvendimi i organit administrativ ka mangësi, për të cilat nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e të njëjtit; (ii) që i njëjti nuk ka përmbajtje siç parashikohet me nenin 84 par.2 dhe nenin 85 të LPK-së dhe (iii) organi administrativ nuk tregon se në bazë të cilave prova nuk mund të vazhdohet procedura e ndërprerë dhe a kanë pushuar rrethanat të cilat më parë kanë shkaktuar ndërprerjen e procedurës në lidhje me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.
23. Kundër Aktgjykimit [A.nr.1315/2011] të 13 shtatorit 2013 të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, me pretendimin për shkelje të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të anulohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të aprovohet kërkesëpadia e precizuar në seancën e 13 shtatorit 2013.
24. Ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore parashtroi edhe AKK me pretendimin për shkelje esenciale të procedurës kontestimore, zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që lënda të kthehet në rishqyrtim.
25. Më 1 gusht 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [AA.nr.357/2013] refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të AKK-së si dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
26. Më 16 mars 2015, AKK përmes Vendimit [nr.03/847/08] përsëri refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës. Në vendimin e saj AKK, ndër të tjera, theksoi se:

“Agjencia Kadastrale e Kosovës përsëri ka shqyrtuar të gjitha dëshmitë ligjore për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike që është deklaruar në të aktgjykimet e gjykatave të përmendura, dhe konstaton se Vendimi i Komisionit të Kamenicës për Kthim të Tokës ish pronarëve, nr. 04-463-9/91 i datës 24.11.1998, nuk mund të zbatohet- të regjistrohet e drejta e pronësisë pranë Drejtorisë për Kadastër, KK i Kamenicës, për shkak, se ngastrat me nr. 199 dhe 200, pronë e ish NSH-së KB “Agroprodukt” Kriva Reka, me seli në Kamenicë janë privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, me Deklaratë të Transferit të Pronësisë nr. 2627 , 46 të datës 14.03.2014, dhe janë bartur tek Ndërmarrja e Re Toka Agroprodukt në Muqivërc, SHPK- me qira për 99 vjet tek Agron Thaçi.

Prandaj, organi i shkallës së dytë refuzon kërkesën e palës për regjistrim të pronës, në bazë të nenit 3.4 (iii) të Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, nenit 8.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MJS 2004/03 dhe nenit 36 të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative të Republikës së Kosovës. Për realizimin e të drejtave të saj pronësore, sipas nenit 30 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit në lidhje me vërtetimin e të drejtave pronësisë pala mund t'i drejtohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës

Supreme, e cila është kompetente që të vendos në çështjet e pronës në mes të AKP-së dhe personave fizik.”

27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër AKP-së pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejshme: DHPGJS) me propozimin (i) për lëshimin e masës së përkohshme dhe (ii) që të obligohet e paditura që të lejojë dhe pranojë që parashtruesi i kërkesës dhe bashkëpronarët e tjerë t'i regjistrojnë pronat e tyre pranë Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Komunën e Kamenicës.
28. Më 23 gusht 2016, DHPGJS përmes Aktvendimit [C-III-13-0476] hodhi poshtë si të papranueshme padinë e parashtruesit të kërkesës. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi thuhej që *“[...] mangësia e legjitimiteti ligjor aktiv, dërgon nga hedhja poshtë e padisë në cilëndo fazë të procedurës sepse paraqet kusht absolutisht negativ për procedime të mëtejshme. Paditësi këshillohet për hedhjen e padisë, ai/ajo ende nuk ka të drejtë që përsëri të dorëzojë padinë, në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-033 krahas Vendimit mbi trashëgiminë, për shkak të legjitimitetit ligjor.”*
29. Kundër Aktvendimit [C-III-13-0476] të 23 gushtit 2016 të DHPGJS, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS.
30. Më 7 shkurt 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS përmes Aktvendimit [AC-I-16-2029-A0001] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [C-III-13-0476] të 23 gushtit 2016 të DHPGJS.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS, duke refuzuar ankesën e tij si të pabazuar, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 3, 24, dhe 46 të Kushtetutës.
32. Sipas parashtruesit të kërkesës atij i është shkelur e drejta e barazisë para ligjit sepse *“nuk është zbatuar vendimi i plotfuqishëm dhe përfundimtar i Komunës së Kamenicës, Komisionit për kthim të tokës numër: 04-453-9/91 të 24.11.1998”, ndër të tjera ai thekson se “ është shkelur neni 24 i Kushtetutës sepse si pjesëtarë i nacionalitetit të pakicës serbe nuk ka pasur mbrojtje të njëjtë ligjore respektivisht ka qenë i diskriminuar”.*
33. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se atij nuk i është aprovuar propozimi për masë të përkohshme, i cili propozim sipas tij ka qenë i *“domosdoshëm”* për mbrojtjen e pronës së tij. Lidhur me këtë ai pretendon se është diskriminuar *“në raport me pjesëtarët e shumicës Shqiptare”* për arsyes se pasuria e tij *“pa bazë”* i ka kaluar në shfrytëzim personit A.TH.
34. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë si në vijim:

“[...] që pas shqyrtimit të të gjitha pretendimeve të paraqitura në ankesë, të vërtetohet që në dëm të parashtruesit të kërkesës është shkelur Kushtetuta dhe atë neni 3, neni 24 dhe neni 46, dhe pas kësaj vendimin e AC-16-0209-A0001 ta shpallë të paligjshëm.”

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

37. Gjykata, më tej, i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-16-2029-A0001] e 7 shkurtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS; i ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe, e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
39. Megjithatë, përveç këtyre kriterëve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

40. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që parashtuesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS, përmes Aktvendimit [AC-I-16-2029-A0001] të 7 shkurtit 2019 i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 3, 24 dhe 46 të Kushtetutës.
41. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në substancë, parashtuesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij gjykatat e rregullta nuk e kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike, për arsye se nuk ia kanë njohur vendimin e Komisionit për kthim të tokës [nr.04-453-9/91] të 24 nëntorit 1998 të Komunës së Kamenicës.
42. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e gabuar të fakteve për sa i takon vendimit për kthimin e tokës si dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga Kolegji i Apelit i DHPGJS dhe ato të instancave më të ulëta, përfshirë edhe AKK-në si organ administrativ që fillimisht ka refuzuar kërkesën e tij për njohjen e të drejtës për regjistrimin e pronës.
43. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata (shih rastin e Gjykatës: KI56/17, parashtuese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
44. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për atë sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e GJEDNJ dhe po ashtu edhe me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se nuk mund të bëhen vlerësime abstrakte se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (shih rastin *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës: KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
45. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtuesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).

46. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para DHPGJS nuk ishin të padrejta apo arbitrare (shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, Nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
47. Në rrethanat e rastit konkret në mënyrë që edhe më konkretisht të elaborohen parimet e përgjithshme të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS e kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktvendimin e DHPGJS, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk kishte mundur ta dëshmojë se kishte legjitimitet aktiv për të kërkuar njohjen e të drejtës në pronësinë e kontestuar.
48. Më saktësisht, Kolegji i Apelit të DHPGJS në aktvendimin e tij kishte theksuar si në vijim:

“Me arsyetimin e aktvendimit theksohet që: përmes Urdhrit të gjykatës të 22 prill 2016, gjykata ka kërkuar nga paditësi që në afatin ligjor të kryejë shqyrtimin e masës së trashëgimisë në gjykatën kompetente ose tek Noteri, ku do të vërtetohet e drejta e tij si trashëgimtar i paraardhësit të tij mbi patundshmëritë në fjalë. Por, përkundër kësaj i njëjti deri në ditën e lëshimit të këtij aktvendimi nuk i ka dorëzuar gjykatës aktvendimin mbi shqyrtimin e trashëgimisë. Për të vërtetuar të drejtën e tij, për të pasur legjitimitet aktiv për të kërkuar njohjen e të drejtës në pronësinë e kontestuar. Dhoma e posaçme arsyeton që përmes nenit 28.2.2 të aneksit të Ligjit nr. 04/L-033, një kërkesë/ankesë është e pranueshme në rast se parashtruesi ka të drejtë të iniciojë një procedurë në kuptim të nenit 1, nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme. Kushti përfundimtar i cili është cituar me këtë nen mund të përmbushet vetëm nëse sigurohet vendimi mbi trashëgiminë. Si pasojë, mungesa e legjitimitetit aktiv në procedurë imponon hedhjen e padisë në cilën do fazë të procedurës. Pasi që paraqet kusht absolutisht negativ për procedim të mëtejshëm të procedurës.

Paditësit i udhëzohet që për shkak të hedhjes së padisë, i njëjti edhe më tutje ka të drejtë të përsërisë të parashtrojë padi, në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 04/L-033, krahas vendimit për trashëgimi, për shkak të karakterit të përgjithshëm universal, nuk mund të vendoset nga ana e trupit gjykues. Një vendim i tillë pasqyrohet në të gjitha pronat tek të gjithë trashëgimtarët dhe ndaj borxhet e të ndjerit. Vendimi jepet nga ana e gjykatës kompetente ose nga ana e Noterit.

Me të gjitha këto gjetje të Kolegjit të specializuar, pajtohet edhe Kolegji i Apelit dhe për shkak të faktit që ankuesi as me ankesë nuk bën asnjë tentim për të siguruar dokumentin mbi trashëgiminë. Ai më shumë merret me punë dytësore. Duke tentuar që ti japë leksion gjykatës, cilat ligje duhet ti zbatojë sipas rastit të tij.”

49. Bazuar në si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë para Kolegjit të Apelit të DHPGJS, përmes ndonjë akti se ai është trashëgimtar i pronës në fjalë, dhe me këtë Gjykata thekson se Kolegji i Apelit

ka vepruar drejtë kur ka hedhur poshtë padinë e tij, për arsye të mungesës së legjitimitetit aktiv.

50. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS apo në gjykatat e tjera të rregullta kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (shih rastin e Gjykatës: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu, rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
51. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se në rrethanat e rastit konkret, Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij themelore, të garantuara me nenet 3, 24 dhe 46 të Kushtetutës.
52. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 3 dhe 24 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton barazinë e individëve që ndodhen në kushte të barabarta dhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj pa asnjë diskriminim. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme të ketë trajtim dhe zgjidhje të njëjlojta (shih rastin e Gjykatës: KI173/18, parashtrues *Nijazi Pasoma*, Aktvendim për papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafi 30).
53. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* dhe nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, që do të tregonte se ai ishte diskriminuar në procedurën pranë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e rregullta (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI44/18, parashtrues *Mega Shop*, Aktvendim për papranueshmëri i datës 8 maj 2019, paragrafin 66).
54. Parimi i njëjtë vlen edhe për pretendimet e parashtruesit të kërkesës para Gjykatës përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të Kushtetutës, pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtës përmes Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (shih, ndër të tjera në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI68/17, me parashtrues të kërkesës, *Hysni Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2018, paragrafi 32; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 51).
55. Përkitazi me këto pretendime, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje

kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 58).

56. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë.
57. Si përfundim, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi